



WEEK OF WOMEN

Java e Gruas në Kosovë 2012

20-24 Mars, 2012

Çka është Java e Gruas në Kosovë?

Java e Gruas është një ngjarje e cila do të mbledhë gratë nga të gjitha sferat e shoqërisë, ku ato do të mund të diskutojnë, identifikojnë dhe tu ekspozohen të gjitha mënyrave që do të bënin pozitën e saj në shoqëri të rritet dhe të jetë më e dallueshme. Java e Gruas do të ftojë gratë lidere të së ardhmes nga të gjitha segmentet e shoqërisë për të marrë pjesë në një Javë Diskutimi ku ato do të mund të diskutojnë, mësojnë dhe identifikojnë shkathësitë dhe teknikat për tu bërë më efektive në fushën e tyre.

Kush do të marrë pjesë në këtë ngjarje?

Në këtë ngjarje do të marrin pjesë njëqind (100) gra duke përfaqësuar partitë politike, Kuvendin, Qeverinë, Qeverisjen Lokale, Mediat, Akademinë, Shoqërinë Civile dhe Biznesin. Java e Gruas në Kosovë do të reflektojë po ashtu pjesëmarrjen nga të gjitha regjionet e Kosovës si për nga etniteti ashtu edhe nga mosha.

Ku do të mbahet Java e Gruas në Kosovë?

Java e Gruas në Kosovë do të mbahet në Prishtinë në Hotelin Swiss Diamond dhe në Universitetin Amerikan të Kosovës (AUK). Për më shumë detaje ju lutem konsultoni Agjendën dhe faqen tonë të internetit në www.weekofwomen.org



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Insituti Kombëtar Demokratik për Marrëdhënie Ndërkombëtare (NDI) është organizatë jo profitabile që punon për të fuqizuar dhe zgjeruar demokracinë në mbarë botën. Duke u thirrur në rrjetin global të ekspertëve vullnetarë, NDI ofron ndihmë praktike për liderët e shoqërisë civile dhe partive politike duke i avancuar vlerat demokratike, praktikat dhe institucionet. NDI punon me demokratët në çdo rajon të botës për të ndërtuar organizatat politike dhe të shoqërisë civile, zgjedhje të sigurt duke promovuar pjesëmarrjen qytetare, transparencën, dhe përgjegjshmërinë nga Qeveria. Për më shumë informata ju lutem konsultoni veb-faqen tonë në www.ndi.org

A e keni ditur se....?

Femrat zotërojnë vetëm 17% të ulëseve në Kongresin e Shteteve të Bashkuara. *Burimi: Fondacioni WCF.*

Rreth një e treta e grave në Sh.B.A thonë se dikush ka tentuar ti dekurajojë ato për të garuar – më së shpeshti ndonjë zotëruar i zyrës apo ndonjë zyrtar i partisë politike. *Burimi: Fondacioni WCF*

Ruanda tani ka përfaqësimin më të madh në botë të femrave si anëtare në parlament. Duke pasuar zgjedhjet e Tetorit 2003 48.8% e deputetëve të Ruandës janë femra, thotë Unioni Ndër-Parlamentar. Suedia, ku 45% e deputetëve janë femra ka qenë më së gjati lidere në rangimin e UNP-së për femrat në parlament. *Burimi: BBC News*

Suedia, Danimarka, Finlanda, Norvegjia, Islanda, Holanda, dhe Gjermania që të gjitha kanë arritur 30% të ulëseve të Parlamentit të fituara nga gratë nga fundi i vitit 2002 bashkarisht edhe me Argjentinën, Kosta Rikën, Afrikën e Jugut dhe Mozambikun. Sipas raportit të progresit të UNIFEM-it për Gratë e Botës në vitin 2002, këto shtete kanë arritur synimet përmes sistemit të kuotës. Mirë po pavarësisht këtyre të arriturave, gratë edhe më tutje përbënin vetëm 14% të parlamenteve në mbarë botën në vitin 2002. *Burimi BBC News.*

Në Maj të vitit 2003, Katari emëroi Sheiken Ahmed Al Mahmud si ministren e parë në kabinetin ministror. Ky emërim u pasua më pas me referendumin e 29 Prillit në të cilin populli i Katarit me shumicë dërmuese aprovoi kushtetutën e shkruar e cila u njëhte grave të drejtën e votës dhe të drejtën për të garuar në poste udhëheqëse. *Burimi: Fondacioni WCF*

Austria ishte i vetmi shtet që zgjodhi një grua si presidente të njëjës nga dhomat e Parlamentit (Bundesratin) para Luftës së Dytë Botërore. *Burimi: Fondacioni WCF*

Në vitin 1995, Suedia bëhet vendi i parë në botë që arriti të kishte numër të barabartë të grave dhe burrave në postet ministrorë. Sidoqoftë aktualisht kabineti qeveritar Suedez është nën nivelin e barazisë me 43% gra ministre. Vetëm 7% e numrit total të kabineteve ministrorë në botë jave gra. *Burimi: Fondacioni WCF*

Në vitin 1893, Zelanda e Re bëhet vendi i parë në botë që u dha grave të drejtën e votës. Në mesin e shteteve që ishin në zhvillim të cilat ishin më të herëshmet në dhënien e të drejtës së votës grave ishin: Finlanda (1906), Shqipëria (1920), Mongolia (1924), Ekuadori (1929), Turqia (1930), dhe Shri Lanka (1931).

Vetëm 1% e aseteve ekonomike botërore janë në emër të grave. *Burimi: Fondacioni WCF*

Si të arrini në lokacionet e Javës së Gruas :

Nëse dëshironi të arrini me autobus në AUK nga Qendra e Prishtinës, mund të përdorni autobusin me numër 4. Autobusi nisët nga statuja e NEWBORN-it, nga ndërtesa e Komunës së Prishtinës, dhe nga gjimnazi Sami Frashëri.

- **Hoteli Swiss Diamond**
- **Universiteti Amerikan në Kosovë**

Ne ju rekomandojmë këto shërbime të taksit nëse do të keni nevojë për to:

London Taxi: + 377 44 300 300
Taxi Roberti: + 377 44 111 999
Taxi Victory: + 381 38 555 333
+ 377 44 111 222

Kontaktet e stafit të NDI:

Pranvera Lipovica / email: pranvera@ndikv.org tel. + 377 44 173 313

Nita Bicurri / email: nitabicurri@ndikv.org tel. + 377 45 318 486

Pajtim Gashi / email: pajtingashi@ndikv.org tel + 377 44 372 104

Adresa e NDI: Rruga: Andreja Gropa, no.1. 10000 - Prishtinë, Kosovë